

**Njoftim për përqendrim, me të cilin Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova do të fitojë
kontroll mbi SPAR ALBANIA SHPK, Republika e Shqipërisë
(lënda nr. 08-86/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.05.2025, dhe të plotësuar më 22.05.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova, me seli të regjistruar në Magjistratja Prishtinë-Lipjan NN, Suhodoll, Graçanicë, Kosovë, do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë tregtare SPAR ALBANIA SHPK, me adresë të regjistruar në Rruga Kombëtare Tiranë – Elbasan, godina “Brunes Space”, përballë hyrjes Violle të qendrës tregtare TEG, Farkë, Lundër, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova është shoqëri që merret me shitje me pakicë të mallrave në dyqane të paspecializuara – supermarkete, ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani.

Viva Fresh SH.P.K. nga Kosova ka shoqëri të lidhura në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si vijon:

- Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Brigada Maqedonaso-Kosovare 11 nr.1/1 Shkup-Butel, me veprimtari prioritare – shitje me pakicë në dyqane të pa specializuara, kryesisht ushqime, pije dhe duhan.
- Shoqëri tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut, shoqëri me veprimtari – tjetër shitje me pakicë në dyqane të pa specializuara.

KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut ka shoqëri të lidhura në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si vijon:

- Shoqëri për tregti, hoteleri dhe shërbime TALFA SHPKNJP SHTIP me seli të regjistruar në blv. Goce Dellçev nr.52, Shtip – Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare – dhënie me qira dhe menaxhim të pasurisë së vet apo të marrë me qira (leasing).
- Shoqëri për tregti dhe shërbime TDELTA-ING 2017 SHPKNJP Shtip, me seli të regjistruar në blv. Goce Dellçev nr.52, Shtip – Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare – dhënie me qira dhe menaxhim të pasurisë së vet apo të marrë me qira (leasing).

SPAR ALBANIA SHPK, e cila është në pronësi 100% të themeluesit të vetëm “Balfin” – “Balkan Finance Investment Group” SHPK, ushtron aktivitetin e saj në shitje me pakicë dhe shumicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, me adresë të regjistruar: Rruga Kombëtare Tiranë – Elbasan, godina “Brunes Space”, përballë hyrjes Violle të qendrës tregtare TEG, Farkë, Lundër, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L51603008A.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

20.05.2025

Shkup